

SHQIPËRIA, PJESË E FUSHATËS EUROPIANE PËR SIGURINË USHQIMORE “SAFE2EAT” 2025

SAFE2EAT

Iniciativë që synon të rrisë ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e sigurisë ushqimore dhe shëndetit publik. Fushata është zhvilluar në 27 vende anëtare të BE dhe financuar nga EFSA dhe Komisioni Evropian

TEMATIKA

Fushata trajton tematika kyçe për shëndetin e konsumatorëve, duke përfshirë: Sëmundjet e transmetuara nga ushqimi, Teknikat e duhura të trajtimit dhe ruajtjes së ushqimeve, Leximi i saktë i etiketave ushqimore, Reduktimi i mbetjeve ushqimore, Siguria e suplementeve ushqimore, Rëndësia e një diete të ekuilibruar, Njohja me aditivët, alergjenët dhe ushqimet e reja



LINK

Materialet informuese të fushatës tashmë janë përkthyer dhe pasqyruar në gjuhën shqipe në faqen zyrtare të EFSA, duke u bërë të aksesueshme për qytetarët shqiptarë dhe profesionistët e fushës. Përkthimet janë realizuar nga kompania e kontraktuar nga EFSA (GOPA Com), ndërsa verifikimi dhe përshtatja janë bërë nga stafi i AKU-së, Koordinatorja Kombëtare dhe Pika Fokale për Shqipërinë.

Për më shumë informacion, vizitoni:



<https://www.efsa.europa.eu/en/safe2eat>

